



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 09.6. 2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Bekë Berisha, kryetar, Enver Dugolli, zëvendëskryetar i parë, Erxhan Galushi, nënkryetar i dytë, Arbër Rexhaj, Fatmir Humolli, Shqipe Mehmeti-Selimi, Mefail Bajqinovci, Elmi Reçica, Abelard Tahiri dhe Anton Quni anëtarë.

Mungoi: Slavko Simić, -anëtar.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes: Gjenerallejtënant Rrahman Rama-Komandant i FSK-së,

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Anita Leka, asistente e kryetarit të komisionit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtur me datë 25.05.2021;
3. Raportimi i Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Rrahman Rama;
4. Shqyrtimi i raportit të panelit përzgjedhës, për Komisionerin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari, të nderuar anëtar të Komisionit, para se të miratojmë rendin e ditës, është një propozim që raportimi i Komandantit të FSK-së, jete i mbyllur për media për shkak se mund të trajtohen tema të cilat janë të ndjeshme dhe prandaj propozoi që raportimi të jete i mbyllur, por për këtë vendose Komisioni. A jeni për mbylljen për media të nderuar deputet?

Komisioni me vota unanime u dakordua që Raportimi i Komandantit të FSK-së, sipas pikës 3 të rendit të ditës të jetë i mbyllur për media.

Ftojme mediat që të marrin pamje dhe më pas të lirojnë sallën. Ju falënderojmë për mirëkuptimin

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtur me datë 25.05.2021.

Procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Raportimi i Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Rahman Rama.

Kryetari në fillim të kësaj pike, beri një prezantim të shkurtër rreth raportimit të Komandantit të FSK-se para Komisionit. Raportimi realizohet në kuadër të mandatit të Komisionit parlamentar dhe është i parapare me planin e punës së Komisionit për vitin 2021. Ky është raportimi i parë i Komandantit të FSK-se në Komisionin e Legjislativës së VIII-të dhe çështje themelore të raportimit janë: Forca e Sigurisë në vitin 2021; personeli në FSK, rritja e kapaciteteve ushtarake dhe reaguese; gjendja e pajisjeve; bashkëpunimi me aleat, misioni në Kuvajt; ushtrimi ndërkombëtar- Defender 2021; kërkesat buxhetore; etj. Pas raportimit të Komandantit, deputetët e Komisionit do të marrin fjalën për pyetje, komente, diskutime lidhur me këto çështje.

Gjenerallejtënant Rahman Rama, ne vijim ka raportuar për të gjitha çështjet e ngritura me fokus planin e tranzicionit të FSK-së i cili është sfidues edhe kërkon angazhim të përbashkët. Ndërsa realizimi i ushtrimit në kuadër të Defender 21, ku 27 vend e kanë qenë pjesëmarrës, 16 vende kanë qenë mikpritëse dhe Kosova ka qenë pjesë e kësaj hartë. Aspekti tjetër i rëndësishëm, është që për herë të parë është bërë validimi i FSK-së. Ndërsa sa i përket aspektit të buxhetit, theksoi se ka planifikim në buxhet për rritjen e tij për FSK-në dhe do të ndikojnë në ngritjen e

kapaciteteve. Tutje theksoi se pjesëmarrja e FSK-së në misionin paqeruajtës në Kuvajt, përbën një të arritur të madhe për FSK-në. Gjithashtu theksoi se duhet të vazhdohet me rekrutimet e reja, pasi kjo është nevojë e procesit të tranzicionit.

4. Shqyrtimi i raportit të panelit përzgjedhës, për Komisionerin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Kryetari, të nderuar anëtar të Komisionit, ashtu siç jeni në dije si Komision jemi përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Në Komision kemi pasur pa pajtueshmëri sa i përket përbërjes së panelit, duke qenë se ka pasur interes që i gjithë Komisioni të jetë në panel, ndërkaq nga opozita është kundërshtuar kjo gjë. Gjithsesi paneli ka vazhduar punën dhe sot kanë sjellë raportin. Fjalën ia kaloi z.Buajr Dugolli-Kryesues i panelit.

Elmi Recica, lidhur me panelin e formuar, theksoi se që nga momenti kur është mbi votuar si PDK janë tërhequr nga ky panel dhe s'kemi qenë pjesë e intervistimit. Shihet që vendimi i marrë për mbi votim, partia që ka fituar zgjedhjet dhe Lista Serbe. Në kuadër të kësaj kemi shprehur qëndrimin që ky proces do të komprometohet dhe procesi do të jetë i diskutueshëm, gjithashtu ka reaguar edhe Shoqëria Civile lidhur me përbërjen e Komisionit dhe për më tepër kemi fakte shtesë s ai përket intervistimit dhe poentimit. Si grup parlamentar i PDK-së, nuk jemi të interesuar të marrim pjesë në këtë takim dhe të dëgjojmë raportin dhe e vetmja çështje që duhet të bëhet është që të kthehet në pikën e nisjes ky proces. Në praktikën e më hershme, ka qenë nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar. Për këtë arsye ne tërhiqemi dhe nuk dëshirojmë të jemi pjesë e kësaj maskarade.

Enver Dugolli, shtoi se gabimisht u nisë, pasi deklaratimet duhet të bëhet pas leximit të raportit.

Kryetari, fjalën e kërkoi Anton Quni, dhe nuk është prishje e rregullave, përderisa nga ana e një deputeti u kërkua fjala. Përderisa ju e keni thyer rregullin në përfshirjen e gjithë Komisionit në panel të gjithë do të deklarohen.

Anton Quni, theksoi se për këtë çështje që nga fillimi kemi pasur qëndrime të ndryshme, gjithashtu nuk është i obliguar të dëgjoj një raport për një proces që ka qenë i komprometuar dhe nuk e sheh të arsyeshme qëndrimin e mëtutjeshëm në këtë takim dhe dëgjimin e raportit. Edhe nga Shoqëria Civile janë bërë vërejtjet, andaj do duhet të shikohet mundësia që ky proces të ndalohet dhe të shpallet konkursi dhe të ndiqen praktikën e më hershme.

Kryetari, shprehi keqardhje që është prishur konsensusi, që në përbërje të panelit të jenë vetëm nga një përfaqësues i grupeve parlamentare, pasi përfshirja e gjithë Komisionit në panel e ka prishur praktikën. Në panel është vlerësuar një kandidat me pikë maksimale, ndërsa në legjislaturën e kaluar e kam votuar me nota minimale dhe uroj që ky kandidat i votuar nga ju me

nota maksimale mos të zgjidhet në krye të Agjencisë. Prandaj unë e konsideroj të mbyllur këtë mbledhje

Enver Dugolli-nënkryetar i parë i Komisionit, i nderuar Kryetra, nuk mund ta mbyllësh takimin pasi unë jam Nënkryetar dhe mund të vazhdoj mbledhje përderisa ka kuorum në Komision.

Ndërsa konsideroi që është për keqardhje ajo çfarë bënë opozita, pasi qëndrimet e tyre mund ti shprehin por të diktojnë procesin, kjo nuk mund të ndodh. Komisioni është i obliguar që këtë proces të shtyjë përpara dhe nuk ka mundësi ligjore që të ndërpritet ky proces. Pra kushtet janë plotësuar dhe janë tre kandidatë që do të dërgohen në seancë. Gjithashtu njoftoi që në ditën e intervistimi, njëri nga kandidatët është tërhequr z.Sadik Kryeziu, për shkaqe shëndetësore. Vlerësimi është bërë në panel, sipas performancës së kandidatëve. Në seancë do të vendoset se kush do të zgjidhet, të tre kandidatët janë kandidatë potencial ndërsa reagimet e opozitës janë më shumë për show mediatik

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës, me gjashtë vota për(Enver Dugolli, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, Erxhan Galushi, Fatmir Humolli) nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti i panelit për përzgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, i njëjti i rekomandohet seancës që prej tre kandidatëve të propozuar, të zgjidhet Komisioneri i Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Tre kandidatët e listuar janë: Enver Bujari, Krenare Sogojeva dhe Edon Myftari.

5. Të ndryshme.

Nuk pati çështje për tu diskutuar.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Bekë Berisha,
Kryetar i komisionit
